



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:080406  
Datë: 23.04.2024  
Numri i dokumentit: 05610570

**A.nr. 962/2022**

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Luljeta Maxhuni, në konfliktin administrativ të paditësit, A.B., themelues i ...” ... për Gjinekologji dhe ..., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson ....., me seli në ... në ... kundër të paditurës, Inspektorati Shëndetësorë - Ministria e Shëndetësisë, me seli në Prishtinë me bazë juridike “anulim i vendimit”, në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur në prani të autorizuarit të palës paditëse dhe në mungesë të palës së paditur, me datë 27.03.2024, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

I.APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit ....., ..

II.ANULOHET aktvendimi i Inspektoratit Shëndetësor të Kosovës – Ministria e Shëndetësisë me Nr.10/K-020/20, i datës 24.03.2022 me numër protokollit 05-282/4 i datës 24.03.2022 dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek i padituri.

III.Obligohet e paditura Inspektorati Shëndetësorë - Ministria e Shëndetësisë, të veprojë nga pikëpamja juridike e kësaj gjykate si dhe nga vërejtjet e dhëna lidhur me procedurën.

**A r s y e t i m**

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike, është mbajtur në kuptim të nenit 41 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative(më tutje LKA-së ), në prani të autorizuarës të palës paditëse dhe në mungesë të palës së paditur e ftuar me ftesë të rregullt (Provë: fletë kthesa e datës 11.03.2024).

E autorizuar e paditëses në padinë e datës 21.04.2022 dhe në seancën mbi shqyrtimin kryesor të datës 27.03.2024 ka deklaruar që mbetet në tërësi pranë padisë si dhe deklaratave të dhëna në seancat e

mëparshme, duke i propozuar gjykatës që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit dhe të anulohet vendimi i të paditurës me nr.05-282/4 i dt.24.03.2022 dhe çështja të kthehet në rivendosje tek e paditura, kjo për arsye se këtë vendim paditësi e ka pranuar me dt.18.02.2022 dhe ashtu siç ishte udhëzuar në këshillën juridike ka paraqitur ankesë me dt.25.02.22, pra në ditën e shtatë, brenda afatit 8 ditor, gjë e cila dëshmohej nga libri i postës e cila dëshmon se ankesa është dorëzuar me dt.25.02.22. E njëjta shton se, e paditura nxjerrë vendimin kontestues me të cilën e refuzon ankesën si të pa afatshme dhe në arsyetim cek se ankesa është dorëzuar me datë 01.03.22, përkundër faktit se si datë e dorëzimit është dashtë të llogaritet dita e dorëzimit me postë, e jo dita kur e paditura e ka pranuar vendimin, për shkak se një gjë e tillë parashihet me dispozita ligjore. Më tutje thekson se, paditësi e ka pranuar vendimin me datë 18.02.22, duke u bazuar në atë se në zarfën e vendimit në njërën anë është e vendosur vula e postës zyrtare Prishtina 12 e cila gjendet në oborrin e QKUK-së, aty ku edhe e ka selinë Inspektorati Shëndetësor, ndërsa në anën e pasme është vula e Zyrës postare në Hajvali e cila mbanë datën 14.02.22 – Zyrë postare kjo që i dërgon zarfet postare për territorin në të cilën gjendet paditësi, ndërsa fakti se paditësi e ka pranuar vendimin me dt.18.02.22 mbështetet në të thënat më lartë si dhe faktin se data 17.02.22 është festë zyrtare dhe për këtë arsye paditësi nuk ka mundur të pranoi postën më herët por e ka pranuar me datën 18.02.22. Gjithashtu e njëjta ka dorëzuar si provë dëshminë e komunikimit me Postën e Kosovës, ku thekson se nga të njëjtit nuk ka marrë përgjigje pozitive, me arsyetimin se nuk kanë mundur ta gjejnë të njëjtën në sistem, edhe përkundër obligimit ligjor që ti ruajnë të dhënat e dërgesave për në afat deri në 5 vite.

E paditura me përgjigjen në padi të datës 16.08.2023, si dhe me parashtrësën e datës 26.03.2024, e konteston në tërësi padinë e paditëses si të pa bazuar, duke theksuar se, vendimi i të paditurës është marrë konform të gjitha dispozitave ligjore në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare, andaj i propozon gjykatës që pas administrimit të provave të marr aktgjykim me te cilin refuzohet në tërësi padia dhe kërkesëpadia e paditësit si e pa bazuar dhe mbetet në fuqi Vendimi i të paditurës - Ministrisë së Shëndetësisë. E njëjta shton se, pala në fillim të procedurës IVF ka bërë pagesë në vlerë prej 3500 Euro, paketa financiare e procedurës IVF për herë të parë në listën e Paketave është shënuar ICSI-1 nuk është aplikuar deri në përfundim në mungesë të qelizave, andaj nuk mund të ngarkohet pacienti me çmimin në vlerë prej 1550 Euro, për analizat laboratorike, vizitat dhe terapinë e administruar. Këto shërbime të cekura në bazë të çmimoreve të institucionit nuk i kap vlerat e shumës prej 1550 sa i ka ndal institucioni palës, pakoja nuk ishte nënshkruar nga pacientja dhe nga institucioni, në çmimore nuk ishte përcaktuar çka përfshin shërbimi ICSI-1 i cili shërbim çmimorin e Institucionit figuron 2000 Euro. E njëjta thekson se çmimi i shërbimit ICSI-1 i cili në çmimore figuron 2000 Euro, nuk përputhet me pakon e ofruar palës ku figuron 3500 Euro.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 27.03.2024, ka bërë administrimin e provave dhe atë: procesverbali mbi inspektimin e kryer dt.12.11.21, vendimi i dt.10.02.21 me numër 10-ND-010-22 dhe me datën e protokolluar 10.02.22 me nr. 05-282, ankesa e dt.25.02.22, fatura me nr.0001536, libri i

pranimi i dt.25.02.22, vendimi i dt.24.03.22 me nr.10-K-020/22, formulari nr.4 i dt.25.05.21, formulari M6 i nënshkruar nga pacienti, formulari M7 i nënshkruar nga pacienti, formulari i medikamenteve i datës 25.05.21, shkresa e datës 16.11.21, formulari mbi çmimet, deklarata e datës 12.11.21, shkresa e dt.31.05.21, vërtetimi i dt.25.05.21, formulari për ankesë i datës 15.06.21, raporti i analizës i datës 01.06.21, formulari M3 i nënshkruar nga pacienti, formulari i datës 30.12.16, analizat e dt.25.05.21 dhe dt.31.05.21, formulari i datës 31.05.21, vërtetimi i datës 25.05.21, zarfi i dt.14.02.22, e-maillet e dt.25.12.23, 28.12.23, 16.01.24 dhe 12.01.24, raporti mbi inspektimin i dt.10.02.22, raporti mbi inspektimin i datës 09.02.22, shkresa e dt.10.11.21, këshillimi juridik me numër 06/2013.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Me vendimin e të paditurës, Ministria e Shëndetësisë me numër 10/K-020/20 të datës 24.03.2022 është refuzuar si e pa afatshme ankesa me numër protokolli 05-282/3 e datës 01.03.2022, e parashtruar nga .... këtu paditësi, ashtu që ka mbetur në fuqi Vendimi i Inspektoratit Shëndetësor me numër protokolli 05-282 i datës 10.02.2022.

I pa kënaqur me vendimin e të paditurës, paditësi ka ushtruar padi në këtë gjykatë me datë 21.04.2022, duke e kontestuar ligjshmërinë e të njëjtit.

Gjykata vëren se vendimi i kontestuar përmban të meta të tilla për shkak të të cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 84 par.2 të këtij ligji është paraparë se akti administrativ, që në këtë rast nënkupton vendimin e goditur me padi, duhet të përmbajë përveç tjerash edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike, bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruara nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilat bazohet akti, etj. Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar. Në nenin 85 dhe 86 të po të njëjtit ligj, parashihet se përveç rasteve ku ligji vet e parashikon dhënien e arsyeve, duhet të jepen domosdoshmërisht arsyet për të gjitha ato akte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në një mënyrë apo tjetër të drejtën dhe interesat ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara, ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar, etj. Arsyetimet duhet të formulohen qartë dhe të përfshijnë shpjegimet e bazës ligjore dhe faktike të aktit.

Vendimi i kundërshtuar është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit

të kundërshtuar. Me tutje, në arsyetimin e vendimit është dhënë formulim i përgjithshëm dhe abstrakt ku thuhet se *“Parashtruesi i ankesës nuk e ka respektuar këshillën juridike të drejtën e ankesës në afatin e paraparë, pasi që në vendimin e Inspektoratit shëndetësor me numër protokolli 05-282 të datës 10.02.2022 është dhënë këshillë juridike për palët, se kundër këtij vendimi, mund të ushtrohet ankesë në afat prej 8 ditësh, nga marrja e këtij vendimi, andaj si e tillë ankesa konsiderohet si e pa afatshme”*.

Gjykata duke vlerësuar ligjshmërinë aktit kontestues të nxjerrë nga organi i paditur, konstaton se nuk qëndron pretendimi se, ankesa e ankuesit në organin e paditur është e jashtëafatshme, pasi që I padituri në vendimin kontestues nuk e ka arsyetuar në asnjë mënyrë kohën- datën se kur është pranuar vendimi i shkallës se pare nga paditësi ndaj të cilit paditësi ka ushtruar ankesë, si dhe nuk ka treguar datën se kur dhe si paditësi ka ushtruar ankesën pran të paditurës.

Në bazë të nenit 82 paragrafi 1.1 i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative përcaktohet se: *“Përveç kur parashihet ndryshe me ligj, për llogaritjen e afateve procedurale kundrejt palës, dita e parashtrimit të kërkesës, do të vlerësohet si dita: 1.1. e parashtrimit të kërkesës, në zyrën postare”*. Pra, gjykata gjen se me rastin e vendosjes në këtë çështje i padituri ka bërë konstatim të gabuar të gjendjes faktike për shkak se në vendimin kontestues e ka shënuar se ankesa e paditësit është protokolluar me datën 01.03.2022, për atë arsye edhe e ka refuzuar ankesën si të pa afatshme, sepse i njëjti si datë të paraqitjes së ankesës e ka marrë datën kur ankesa është pranuar nga ana e të paditurit, respektivisht kur është protokolluar nga i padituri, e jo datën kur paditësi e ka dorëzuar ankesën në postë, pra datën ashtu siç pretendon e autorizuara e paditësit date 25.02.2022.

Pra, i padituri me rastin e nxjerrjes së vendimit kontestues ku i ka refuzuar ankesën paditësit si të pa afatshme nuk ka vepruar konform nenit 82.1 të LPPA-së, i cili thekson se dita e parashtrimit të kërkesës/ankesës do të konsiderohet dita kur pala e dorëzon kërkesën në zyrat postare, e nuk konsiderohet dita kur kërkesa e tillë pranohet nga organi përgjegjës. Pra, i padituri as në vendimin kontestues, as në Përgjigjen në padi dhe parashtrësat për deklaram për seancë nuk ka dëshmuar asnjë provë nga e cila mund të vërtetohej fakti se paditësi ka parashtruar ankesën jashtë afatit ligjorë.

Më tutje nga provat e administruara gjykata gjen se me e-mailin e datës 25.12.2023 përfaqësuesja e paditësit ka kërkuar nga Posta e Kosovës informata se me cilën datë është pranuar zarfi, respektivisht vendimi nga paditësi ....., mirëpo përgjigja e tyre ishte se për shkak të periudhës së gjatë kohore nuk mund ta verifikojë këtë gjë. Andaj në këtë kuptim, gjykata vlerëson se organi i paditur, nuk e ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike, nuk ka zbatuar drejtë Ligjin për Procedurën Administrative dhe ligjin material, kur paditësit me vendimin e goditur në padi, i është refuzuar ankesa si e pa afatshme.

Gjykata si rregull konfliktin administrativ e vendosë në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga ana e organeve administrative, ndërsa nga vendimi i goditur me padi nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike.

Të metat e caktuara më lartë janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kundërshtuar dhe në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur që në ri-procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi ti mënjanoj të metat e cekura, të merr vendim të drejtë të bazuar në ligj. Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur , duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, në kuptim të nenit 5,6 dhe 38 dhe në përputhje me Nenet 43.2, si dhe Nenet 46.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Çështje Administrative

A.nr.962/2022 data: 27.03.2024

G j y q t a r e  
Luljeta Maxhuni

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.